



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 14, datë 20.07.2022

**PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT SË ZONJËS HOLTA ZAÇAJ NË VENDIN
VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA
GJYKATA E LARTË NË DATAT 21.02.2019, 19.04.2019, 03.06.2021 DHE 15.11.2021**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Sokol Binaj	Kryetar
Marsida Xhaferllari	Zëvendëskryetare raportore
Elsa Toska	Anëtare
Edlira Petri	Anëtare
Enton Dhimitri	Anëtar
Anila Leka	Anëtare
Genti Xholi	Anëtar zëvendësues
Etien Kapo	Anëtar
Klodiana Veizi Mema	Anëtare

Asistuar nga sekretare Ermelinda Kadiu.

Me praninë e Avokates së Popullit, Znj. Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve: Z. Bledar Dervishaj, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës dhe Znj. Mimoza Arbri, përfaqësuese e autorizuar e Kuvendit të Republikës, në mbledhjen e datës 20.07.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: Holta Zaçaj

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar, në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 21.02.2019, datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe datë 15.11.2021.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relativimin e anëtares së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), Znj. Anila Leka, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, Znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 21.02.2019, Gjykata e Lartë ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, pas largimit nga detyra të gjyqtarit Gani Dizdari.
2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), duke mos u plotësuar numri i kandidatëve për këtë vend vakant, me vendimin nr. 6, datë 05.04.2019, ka vendosur “Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur”, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave.
3. Gjykata e Lartë ka rishpallur, më datë 19.04.2019, hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant, në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Ndodhur në kushtet e mungesës së kandidaturave, më datë 03.06.2021, Gjykata e Lartë ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant dhe, pas përfundimit të afatit, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar.
5. Më datë 12.07.2021, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 6, datë 05.04.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave”, si dhe rifillimin e procesit të shqyrtimit të kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, duke përfshirë në një listë të përbashkët, të gjithë kandidatët që i ishin përgjigjur të gjitha shpalljeve.
6. Me vendimin nr. 10, datë 30.09.2021, duke qenë se numri i kandidatëve ra përsëri nën tre, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur “Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave”.
7. Më datë 15.11.2021, në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000), Gjykata e Lartë ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

8. Në përfundim të afatit të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kryetari i Gjykatës së Lartë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën përfshihej dhe kandidatja Holta Zaçaj, së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore, të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000
9. Më datë 20.01.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 10, datë 30.09.2021 *“Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave”*, si dhe vijimin e procesit të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që konkurrojnë për vendin vakant të ish gjyqtarit Gani Dizdari.
10. Në të njëjtën mbledhje të datës 20.01.2022, KED-ja realizoi edhe procedurën e shortit manual për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjedh anëtarja Anila Leka, ndërsa këshilltarë ligjorë Besmir Rrapaj dhe Edlira Llango.
11. Në datën 21.01.2022, kandidatja Holta Zaçaj u njoftua me shkrim, në rrugë elektronike për t’u paraqitur brenda tre ditëve në zyrën e posaçme të KED-së për tërheqjen e formularëve standard dhe të udhëzimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidimit të tij. Ky njoftim u krye në zbatim të pikës 22 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së.
12. Në datë 25.01.2022, përfaqësuesja me prokurë e kandidates Holta Zaçaj, u paraqit pranë KED-së, tërhoqi për plotësim formularët standard të deklarimit dhe autorizimeve e duhura për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi. Në datën 31 Janar 2022, nga ana e përfaqësuese me prokurë të kandidates janë paraqitur formularët standard të deklarimit dhe autorizimeve për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi, jetëshkrimi i kandidates, si dhe dokumentacion mbështetës.

II. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve kushtetuese dhe ligjore të kandidimit

A. Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë së kandidatit dhe familjarëve të tij sipas ligjit.

13. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, të nenit 7/a pika 1 gërma “dh” të ligjit nr. 8577/2000, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. prot.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

18, datë 04.02.2022, Këshilli i ka dërguar, ILDKPKI-së, listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procesit të kontrollit të pasurive, interesave financiarë dhe konfliktin e interesave, sipas ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367/2005.

14. Bashkëlidhur kësaj shkrese të drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe "Deklarata" e nënshkruar nga Znj. Anjeza Puka, përfaqësuese me prokurë e kandidates Holta Zaçaj, në të cilën tregohet/konfirmohet se është pajisur me formularët përkatës të deklarimeve dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj dhe, që mban datën 25.01.2022 të nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.
15. Në zbatim të nenit 235 pika 2 të ligjit nr. 115/2016, të nenit 7/a pika 1 shkronja "dh" të ligjit nr. 8577/2000, dhe pikës 61 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", si dhe përcaktimeve të neneve 3/1, 4 pika 2 e vijues të ligjit 9049/2003, kandidatja Holta Zaçaj ka plotësuar në mënyrë elektronike dhe ka dorëzuar të printuar e nënshkruar, brenda 15 ditëve, pranë ILDKPKI-së. Deklaratën e "*pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë*".
16. ILDKPKI, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, si dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe vendimit nr. 4 të datës 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pasi ka kryer, brenda 30 ditëve, verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kësaj candidate, bashkëlidhur me shkresën nr. 851/5 prot., datë 27.04.2022, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, aktin e kontrollit të plotë nr. prot. 676/23, datë 27.04.2022, në përfundim të së cilës ka konstatuar se, për kandidaten Holta Zaçaj:
 - a) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
 - b) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.*
 - c) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - ç) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - d) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
17. Gjatë kësaj periudhe, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës "e" të pikës 20, 24, shkronjës "b" të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Holta Zaçaj dhe personave të lidhur me të.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri**
Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

18. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatës **Holta Zaçaj**, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, më shkresat datë 15.02.2022, datë 17.02.2022, datë 30.03.2022, datë 27.05.2022 dhe datë 31.05.2022, ka kërkuar informacion, prej institucioneve publike dhe subjekteve private, si vijon:
- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka OTP, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union.
 - b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing SHA, (3) Capital Invest SHA, (4) Easypay SHPK, (5) Final SHPK, (6) Fondi Besa SHA, (7) Iutecredit Albania SHA (8) Landeslease SHIA, (9) M – Pay SHPK (10) NOA SHA, (11) Porsche Leasing SHA, (12) Posta Shqiptare SHA, (13) Raiffeisen Leasing SHA, (14) Tirana Factoring & Lease SHA, (15) Tranzit SHA, (16) Union Financiar Tiranë, (17) Agrokredit SHA.
 - c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF: (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal, (9) ABI INVEST SHA, (10) ALBSIG INVEST, (11) Credins Invest SHA-Shoqëri Administruese e Fondeve, (12) Raiffeisen Invest Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA, (13) WVP Fund Management Tirana SHA.
 - ç) Institucione të tjera publike si: (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), (2) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), (3) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), (4) Ministrisë së Drejtësisë (MD), (5) Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) SHA, (6) Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), (7) Ujësjellës Kanalizime Tiranë (UKT) SHA.
19. Nga të gjithë institucionet publike dhe subjektet private të sipërcituara, për kandidaten **Holta Zaçaj** dhe personat e lidhur me të, kanë përcjellë të dhëna mbi ekzistencën e llogarive dhe trasaksioneve të kryera, të verifikuara edhe nga ana e ILDKPI-së:
- “1) **Banka Alpha Albania SHA** me shkresën nr. 8923 prot., datë 17.02.2022;
Banka Credins SHA me shkresën nr. 13675/1 prot., datë 23.02.2022;
Banka Intesa Sanpaolo Albania SHA me shkresën nr. 22-12839/1 prot., datë 03.03.2022;
Banka Kombëtare Tregtare SHA me shkresën nr. 921/1 prot., datë 01.03.2022;
Banka OTP Albania SHA me shkresën nr. 22/02764/tbo-002 prot., datë 18.02.2022;
Banka Procredit SHA me shkresën nr. OP-12539/1 prot., datë 22.02.2022;
Banka Raiffeisen SHA me shkresën nr. 7334/1 prot., datë 21.02.2022.
 - “2) **M – Pay SHPK** me shkresën nr. prot. 11/1, datë 16.2.2022, ka informuar se *personi i lidhur Erjon Rakip Duraj ka qenë i regjistruar në shërbimin M-Pay.*
Posta Shqiptare SHA, me shkresën nr. 385/1 prot., datë 25.2.2022, ka informuar se *rezulton të jenë kryer veprime financiare dhe transferata kombëtare.*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*
 Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

AK-INVEST SHA, me shkresën nr. 463 prot., datë 23.02.2022, ka informuar se shtetasi Erjon Duraj, i datëlindjes 9.12.1979, nuk ka llogari, nuk është klient kredimarrës dhe nuk rezulton të ketë kryer transferta monetare përmes rrjetit tonë. Megjithatë, nga një kërkim më i detajuar në databazën që administrojmë, rezulton një shtetas i quajtur Erjon Duraj, për të cilin nuk disponojmë të dhënat për gjeneralitetet e tij dhe që ka kryer transaksionet me të dhëna si më poshtë: Një transfertë monetare, si përfitues, datë transaksioni 27.11.2012, shuma 33,363.43 ALL, me dërgues shtetasin Arben Duraj, shteti GB.

- “3) **UKT**, me shkresën nr. K-372/1 prot., datë 4.3.2022, ka bërë me dije se: Në emër të Znj. Holta Vladimir Zaçaj rezulton kontrata nr. 154109-1, për objektin me adresë: “Vaso Pasha”, me status “aktiv” në kategorinë e konsumatorëve privatë, me detyrime të palikujduara me vlerë 276,432.00 lekë. Nga kontrolli në arkivën e UKT SHA, disponojmë kontratë shiue pasurie të paluajshme (me kusht), dokumentin e identifikimit ID. Në emër të Z. Erjon Rakip Duraj rezulton kontrata: nr. 874496-1 për objektin me adresë: “Farkë, Fshati Lundër-Kompleksi Toskany”, me status “aktiv”, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të palikujduara me vlerë 17,665.20 lekë. Nga kontrolli në arkivën e UKT SHA, disponojmë: certifikatë për vërtetim pronësie, kartela e pasurisë së paluajshme, dokumentin e identifikimit ID.

Lidhur me të dhënat e dërguara nga UKT, të cilat iu dërguan kandidatës me e-mail, më datën 1.7.2022, kandidatja Holta Zaçaj, me emailin e dërguar në KED më datë 5.7.2022, ka sqaruar se:

1. Për kontratën e nr.154109-1, që i përket objektit me adresë: “Vaso Pasha”, me status “aktiv” në kategorinë e konsumatorëve privatë, detyrimet e palikujduara me vlerë 276,432.00 lekë i takojnë Roland Caushaj, pronarit të mëparshëm të pronës dhe jo mua. Detyrimi i vetëm, që më takon mua, është për muajin Qershor 2022 në masën 20760.00 ALL dhe do të paguhet brenda afatit nga qiramarrësi, i cili ka marrë me qira pronën. (Ju lutem shihni bashkëngjitur ekstraktin e marrë nga UKT).

2. Z. Erjon Rakip Duraj rezulton kontrata: nr. 874496-1 për objektin me adresë: “Farkë, Fshati Lundër-Kompleksi Toskany”, ju lutem shihni bashkëngjitur pagesen perkatëse.

Në mbështetje të kësaj përgjigjeje, kandidatja ka dërguar bashkëlidhur me emal në KED, faturat/ekstraktin e marrë nga UKT dhe mandat arkëtimin për pagesën e detyrimit më datë 5.7.2022.

QKB, me shkresën nr. 4607/1 prot., datë 23.2.2022, ka bërë me dije se: nga cerifikimi i kryer mbi bazën e emrit, si kriter i vetëm kërkimi, rezulton se:

- Shtetasja Holta Vladimir Zaçaj, e datëlindjes 12.1.1976, figuron të ketë qenë ortak me 99% të kuotave në shoqërinë “DE LEGIBUS COUNSULTING” SHPK, me NUIS (NIPT) K81924011V, larguar me CN-723708-11-14, datë 18.11.2014. Bashkëlidhur, po ju vëmë në dispozicion ekstraktin historik të regjistrit tregtar të subjektit “DE LEGIBUS COUNSULTING” SHPK, me NUIS (NIPT) K81924011V.

- Shtetasi Erjon Rakip Duraj, i datëlindjes 9.12.1979, figuron ortak me 99% të kuotave në shoqërinë “DE LEGIBUS COUNSULTING” SHPK, me NUIS

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

(NIPT) K81924011V dhe figuron të ketë qenë administrator larguar me CN-837146-01-15, datë 29.1.2015. Bashkëlidhur, po ju vëmë në dispozicion ekstraktin historik të regjistrimit tregtar të subjektit "DE LEGIBUS COUNSULTING" SHPK, me NUIS (NIPT) K81924011V.

- Shtetasi Erjon Duraj, i datëlindjes 9.12.1979, figuron të ketë qenë administrator, larguar me CN-170382-02-17, datë 24.2.2017 në shoqërinë "Albchrome" SHPK, me NUIS (NIPT) K11613001M. Bashkëlidhur, po ju vëmë në dispozicion ekstraktin historik të regjistrimit tregtar të subjektit "Albchrome" SHPK, me NUIS (NIPT) K11613001M.

MD, me shkresën nr. 954/1 prot., datë 4.3.2022, ka përcjellë informacionin për të gjitha veprimet dhe aktet noteriale të regjistruara në sistemin RNSH, në periudhën duke filluar nga data 1.3.2013, deri në datën 3.3.2022 të kryera nga noterë të ndryshëm për: 1. Holta Vladimir Zaçaj dhe Erjon Duraj me NID H91209098M dhe datëlindje 9.12.1979 (atësia mungon në sistemin RNSH).

DPSHTRR, me shkresën nr. 3741/3 prot., datë 23.2.2022, ka bërë me dije se, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Mjeteve rezulton se, Erjon Rakip Duraj, mbajtës i numrit personal H91209098M, ka pasur të regjistruar në DPSHTRR mjetet me targa AA 370 SV, AA 226 PB.

DPT, me shkresën nr. 2410/1 prot., datë 24.2.2022, ka bërë me dije se, pas verifikimeve të bëra në sistemin informatik tatimor C@ts, më datë 21.2.2022, ju informojmë se:

- Për shtetasen Holta Zaçaj me ID H65112129V, rezulton të ketë pasur aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të saj:

* Përfaqësues ligjor për periudhën 17.12.2004-6.5.2013, e subjektit Q.E.SHERB. DHE PRAKT. LIGJ.Q.SH.P.L.I. (Organizatë fitimprurëse me NIPT K51509011A;

* Administratore që nga 17.12.2004 dhe aktualisht e subjektit SE BASHKU KUNDER TRAFIKIMIT TE FEMIJEVE, (Organizatë jo fitimprurëse), me nipt K41909012T, themeluar më 19.02.2003, me status pasiv që nga 26.03.2020. Subjekti nuk ka përgjegjësi të deklaratave të Tatimit Fitimit. Subjekti ka përgjegjësi të Tatimit në Burim që nga dhjetor 2014, por në deklaratat e dorëzuara nuk ka të dhëna për qiranë. Bashkëlidhur deklaratat e Tatimit të Mbajtur në Burim dhjetor 2014 (e para e dorëzuar) dhe shkurt 2019 (e fundit e dorëzuar);

*Administratore e subjektit HOLTA KOTHERJA, (Person Fizik), me NIPT: K62413001N, themeluar me 13.12.2006, me status ç' regjistruar që nga 13.10.2008. Bashkëlidhur Informacioni i përgjithshëm, adresa dhe Deklarata e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël për vitin 2008. Subjekti nuk ka deklarata të tjera, nuk ka listëpagesatë dorëzuara, nuk ka balance, nuk ka të dhëna për ambientet ku është zhvilluar aktiviteti (qira apo në pronësi).

- Për shtetasin Erjon Duraj, me ID H91209098M, rezulton të ketë ose të ketë patur aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të tij. Bashkëlidhur kopje-ekstraktet "Lista e subjekteve të personave/tatimpaguesve të lidhur" dhe

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

ekstrakti historik i punësimit. Administrator për periudhën 09.02.2016-24.02.2017, i subjektit Albchrome SHPK, me NIPT: K11613001M, themeluar më 13.04.2001, me status aktiv;

**Administrator për periudhën 04.09.2014-29.01.2015 dhe aksioner me 99% të kuotave të aksioneve që nga 04.03.2016, i subjektit DE LEGIBUS CONSULTING SHPK, me NIPT: K81924011V, themeluar më 24.07.2008, me status aktiv.*

ASHK, Drejtoria e Përgjithshme, me shkresën nr.prot.3706/1. datë 28.2.2022, ka bërë me dije se, nga verifikimi rezulton se ka aplikim si vetëdeklarues, në bazë të ligjit nr.prot.10186, datë 5.11.2009. "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin", i ndryshuar, shtetasja Holta Zaçaj (mungon atësia) (nr. 787, person i stimuluar Fatmir Musaj). Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin dixhital të vendimeve të legalizimit rezultojnë të pajisur me vendim legalizimi: Holta Zaçaj (mungon atësia) (nr. vendimi 82098, datë 13.3.2013).

ASHK, Drejtoria Vendore Zonat e Simuluara, ka bërë me dije se përsa i përket subjektit Holta Vladimir Zaçaj, rezulton të jetë pajisur me Leje legalizimi nr. 82098, datë 13.3.2013, godinë banimi 3 kate, me adresë në zonën e stimuluar Fatmir Musaj, Qerret, Kavajë.

ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën nr. 1053/1 Prot., datë 9.3.2022, ka bërë me dije se, në emër të kandidates Holta Vladimir Zaçaj rezultoi e regjistruar pasuria me nr. 1/375+1-1, vol. 19, fq. 193 zk. 3101. e llojit apartament banimi 3 kat (tripleks), e regjistruar me leje legalizimi sipas referencës 00003409. Më pas këtë pasuri e ka tjetërsuar në emër të Z. Albano Tajar Shehu, nëpërmjet kontratës së shitjes, sipas referencës 00003425.

ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresën nr. 4310/1 prot., datë 20.6.2022, ka bërë me dije se, përsa i përket pasurive të regjistruara, nga kërkimi dhe verifikimi në sistemin multifunksional, rezulton se në emër të shtetasës Holta Zaçaj, figurojnë të regjistruara pasuri, duke bashkëlidhur kartelat e pasurive dhe referencat përkatëse.

B. Deklarimi dhe kontrolli i integritetit të kandidatit.

20. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës "ç" të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me shkresën nr. 50 prot., datë 15.02.2022 dhe shkresën nr. 310, datë 17.03.2022, Këshilli Emërimeve në Drejtësi ka dërguar, në Prokurorinë e Përgjithshme, për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja Holta Zaçaj sipas ligjit nr. 138/2015.
21. Në Formularin e vetëdeklarimit të kandidates Holta Zaçaj, me atësi Vladimir, amësi Adriana, lindur më datë 12.01.1976 në Tiranë dhe banuese në Massachusetts, SHBA, me nr. ID H65112129V, të plotësuar me datë 31.01.2022 sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, të ndryshuar, dhe dorëzuar në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

konform kërkesave të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016 dhe pikës 79 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, rezulton se:

- Në rubrikën “B” të kreu I-ë, të formularit që ka të bëjë me të dhënat personale, ky person ka vetëdeklaruar si gjeneralitet të mëparshëm, mbiemrin “Kotherja”, ndryshe nga mbiemri aktual.
- Në kreu e III-të, që kanë të bëjnë me të dhënat mbi gjendjen gjyqësore të personit, në pyetjet me numër 1-8, ky person ka mohuar (x) dhe nuk ka vetëdeklaruar ndonjë të dhënë që:
 - të jetë dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj;
 - të jetë dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - të ketë qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen një vepre penale;
 - të ketë qenë ndonjëherë e ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen një vepre penale;
 - të jetë caktuar ndaj personit të saj ndonjëherë masë shtënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo;
 - të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj personit të saj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
 - të jetë marrë ndonjëherë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
 - të ketë jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj.

21.1 Me e-mailin e datës 10.3.2022, kandidatja Holta Zaçak ka bërë me dije se: *“në Formularin e Vetëdeklarimit për Zbatimin e Ligjit Nr. 138/2015 “Për Garatimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrijnë Funksione Publike”, në pikën 8, kam zgjedhur përgjigjen JO, për pyetjen nëse kam jetuar më shumë se një muaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Këtë përgjigje e kam dhënë duke interpretuar se nuk kam qendruar në asnjë vend tjetër për një periudhë më të gjatë se një muaj përveç vendeve të rezidencës të cilat janë Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Faktin që jam rezidente në SHBA e kam bërë të ditur në të gjithë dokumentat e tjera të dorëzuara ku është kërkuar apo deklaruar nga unë adresa ime në SHBA. Gjithashtu kjo gjë është bërë e ditur edhe nga komunikimet e vazhdueshme me institucionin tuaj, të cilit i kam vënë në dispozicion edhe kopje të prokurës së personit të autorizuar për të dorëzuar apo tërhequr dokumentat përkatës për shkak të aplikimeve të mia për vakancat e sipërpërmendura, duke sqaruar se përdorimi i prokurës ka qënë i nevojshëm për shkak të rezidencës time në SHBA.”.*

22. Prokuroria e Përgjithshme, në përgjigjen e kthyer me shkresën nr.prot. 217/1, datë 23.02.2022, ka bërë me dije, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se: *“Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të bashkëpunimit mes institucioneve, për sa i përket verifikimit të figurës dhe integritetit të kandidatit, në referim nenit 228 dhe nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “ Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka vijuar duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion të plotë prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, sipas objektit të veprimtarisë së tyre, lidhur me*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

çështjet penale/ procedimet penale të rregjistruara ndaj secilit kandidat të përcjellë. Ky informacion do t'ju vihet në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për të kryer verifikimin e plotë/ thelluar të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, nëse do të vlerësohet e nevojshme nga ju, jemi në pritje të kërkesës suaj (neni 5, neni 7 e neni 8 pika 4 të ligjit nr. 138/2015):

- për emrat e kandidatëve për të cilët nevojitet verifikimi i plotë/ thelluar të të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti në formular, së bashku me,

- dokumente që përmbajnë indicie/ të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht që përbëjnë shkak për zbatimin e këtij ligji, si dhe ato të deklaruar ndryshe, sikurse janë deklaruar në formular, nga verifikimi paraprak i kryer prej jush (si organ përgjegjës për administrimin e formularit) në zbatimin e Kreut III dhe të Kreut V-ë, pika 1, 2, 3 të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë (neni 6 i ligjit nr. 138/2015)".

23. Në vijim, Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. prot. 217/3, datë 04.03.2022, ka bërë me dije, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, se: "Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formularin e plotësuar nga subjekti i këtij ligji, bazuar në kërkesën e bërë brenda 5 ditëve nga organi kompetente përgjegjës, për administrimin e formularit të vetëdeklarimit, (neni 5 i ligjit nr. 138/2015):

- mbi bazën e një kërkesë, ose kryesish kur disponon të dhëna apo fakte përfshirë fakte të njohura botërisht, që përbëjnë shkak për zbatimin e këtij ligji, (pika 4 e nenit 8 të ligjit nr. 138/2015);

- kur ka informacion dhe është e nevojshme, që verifikimi të kryhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, (pika 9 e nenit 8 të ligjit nr. 138/2015.)

..... Në kushtet e sipërcituara të ligjit, Prokuroria e Përgjithshme, sikurse ju ka sqaruar dhe me shkresën tonë nr. 217/1, datë 28.02.2022, ju kërkon plotësimin e të metave të kërkesës suaj, brenda 15 ditëve nga marrja e kësaj kërkesë, për të mos u bërë pengesë për kryerjen e procesit të verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe të ligjit nr. 115/2016.

.....Gjithashtu ju bëjmë me dije se nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të krijuar për këtë qëllim në Prokurorinë e Përgjithshme, rezulton që:

- Për Holta Vladimir Zaçaj, kandidate për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 15.11.2021, nuk është kryer ndonjë proces verifikimi në zbatim të ligjit nr. 138/2015..."

24. Për verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Holta Zaçaj, në zbatim të shkronjës "ç" të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", dhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut II e V-së të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si organi kompetent i

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

administrimit të vetëdeklarimeve dhe zbatimin e ndalimeve për kandidatin. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka kërkuar informacion:

- me shkresën nr. 47 prot., datë 15.02.2022, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila me shkresën nr. 1654/1 prot., datë 25.02.2022, ka kthyer përgjigje se: *“Me lidhjen e martesës më datë 22.5.1996, shtetasja në fjalë ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, duke e ndryshuar këtë përbërës nga “Zaçaj”, në “Kotherja”. Me zgjidhjen e martesës më datë 25.7.2009, shtetasja në fjalë ka marrë mbiemrin “Zaçaj”;*
- me shkresën nr. 48 prot., datë 15.02.2022, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve e cila me shkresën nr. 1804/1 prot., datë 21.02.2022, ka kthyer përgjigje se: *“Rezulton e padënuar nga gjykata penale shqiptare.”.*

25. Me shkresën nr. 217/40 prot., datë 05.04.2022, Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë bashkëlidhur vendimin datë 04.04.2022, për mospranimin e kërkesës së KED-së nr.prot.50, datë 15.02.2022, për kryerjen e verifikimit të të dhënave në Formularin e Vetëdeklarimit datë 31.01.2022, për personin Holta Vladimir Zaçaj, kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*
26. Mospranimi i kërkesës së KED-së nr. prot.50, datë 15.02.2022, sipas vendimit të sipërcituar është kryer për arsye se, nuk përmbushen kushtet dhe kriteret e kërkuara në pikat 1, 4 e 9 të nenit 8 nga ligji nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”* dhe në pikat 1, 2/c, 3/b-ii, 4 të Kreut V-së nga Vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në bazë të të cilave Prokuroria e Përgjithshme detyrohet të kryejë procesin e verifikimit, me qëllim për të verifikuar saktësinë e të dhënave të pasqyruara në formularin e vetëdeklarimit dhe për të konstatuar nëse rrethanat janë të ndryshme dhe se personi është subjekt i ndalimeve sipas këtij ligji.*
27. Gjatë procesit të verifikimit të kryer në zbatim të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 e nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016, të pikave 79-87 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë, 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, si edhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut II e V-së të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për këtë candidate:
- nuk ka konstatuar asnjë të dhënë apo fakt, indicie mbi bazën e një kërkesë, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave qe kanë të bëjnë me:
 - dënime penale me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - dënime penale me vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri*
Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

- masë sigurimi personal nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë, apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
- urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
- dëbime nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit.
- nuk ka konstatuar të deklaruar në formular të dhëna që kanë të bëjnë me faktet e sipërpërmendura apo të dhëna që *prima facia* të përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015;
- nuk ka konstatuar që të jetë kërkuar, nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës, për verifikimin e të dhënave në Formularin e Vetëdeklarimit, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

C. Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore

28. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Holta Zaçaj në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

i. Kontrolli mbi gjendjen gjyqësore dhe proceset penale të regjistruar ndaj kandidatit (neni 7/a, pika 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 8577/2000).

29. Për verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Holta Zaçaj, sikurse është cituar dhe më sipër në pikën 24 të këtij relacioni, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka kërkuar informacion, me shkresën nr. 48 prot., datë 15.02.2022, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila me shkresën nr. prot. 1804/1, datë 21.02.2022, ka kthyer përgjigje se: “Rezulton e padënuar nga gjykata penale Shqiptare”;

30. Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. 646/2 prot., datë 30.03.2022, të dërguar në përgjigje të kërkesës nr. 310 prot., datë 17.03.2022 së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ka trasmetuar përgjigjen e Zyrës së Protokoll-Arkivës, e cila ka informon se:

Për shtetasen Holta Vladimir Zaçaj, nga verifikimit e kryera nuk ka të dhëna për dënime penale të formës së prerë ose jo përfundimtare të dhëna nga autoritete të huaja, masa sigurimi të caktuara nga autoritete gjyqësore të huaja, urdhër kërkimi ndërkombëtar të lëshuar nga autoritete ligjzbatuese të huaja, procedime penale të

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

regjistruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me identitetet të ndryshme, nga ato që kanë momentalisht, nuk mund të japim informacion, pasi nuk është në kompetencën tonë.

31. Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, bashkëlidhur me shkresën nr. prot. 217/42, datë 08.04.2022, ka dërguar, në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, informacionet e marra, nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apeleve, sipas së cilave, vetëm Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. 3109/1 prot., datë 16.03.2022, ka bërë me dije se:

Ndaj shtetases Holta Vladimir Zaçaj, e datëlindjes 12.1.1976, është regjistruar kallëzimi penal nr. 4207, viti 2015, për të cilin është marrë vendim mosfillimi të procedimit penal më datë 15.5.2015, si dhe procedimi penal nr. 7616, viti 2019, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili është dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim më datë 14.5.2019.

32. Në lidhje me procedimet penale nr. 4207, viti 2015 dhe nr. 7616, viti 2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. prot. 458, datë 23.05.2022, ka kërkuar informacion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me shkresën nr. 1394 prot., datë 07.06.2022, ka kthyer përgjigje, se:

"Pas verifikimeve të bëra në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Penale të Gjykatës për periudhën 2015 – 2022, lidhur me shtetasen Holta Vladimir Zaçaj, nuk rezultojnë të ketë pasur ankim për vendimin e mosfillimit të procedimit penal me nr. 4207, të vitit 2015. Në lidhje me procedimin penal nr. 7616, të vitit 2019, bashkëlidhur ju dërgojmë vendimin nr. 2756 akti, datë 25.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."

Me vendimin nr. 2756 akti, datë 25.6.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *"Pushimin e procedimit penal nr. 7616 regjistruar pranë prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 1.10.2018, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal."* Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar më datë 31.7.2019.

33. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), me shkresën nr. 456 prot., datë 23.05.2022, i ka kërkuar informacion Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), e cila, me shkresën nr. 4423/1 prot., datë 27.05.2022, ka kthyer përgjigje se:

"Pas verifikimit në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nuk rezultojnë që në emër të Holta Vladimir Zaçaj e datëlindjes 12.01.1976, me nr. personal H65112129V, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal"

34. Në vijim të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatës Holta Zaçaj, në zbatim të shkronjës "ç" të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *"Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"*, Këshilli i

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Emërimeve në Drejtësi u ka kërkuar informacion, me shkresën nr. 46 prot., datë 15.02.2022 Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe, me shkresën nr. 49 prot., datë 15.02.2022, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme.

35. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 820 prot., datë 16.03.2022, ka informuar se: *“Në përfundim të procedurave të verifikimit, nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e Znj. Holta Vladimir Zaçaj, në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.”*
36. Ndërsa, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme, me shkresën nr. 300/1 prot., datë 22.02.2022, ka informuar se, kandidatja Holta Zaçaj: *Nuk figuron të jetë e evidentuar për veprimtari kriminale dhe as lidhje të personave me precedent kriminal.*
37. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të neneve 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 45 prot., datë 15.02.2022, KED i ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Holta Zaçaj, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.
38. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, pas kontrollit të ushtruar, me shkresën nr. 321/3 prot., datë 11.03.2022, ka përcjellë, në Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, vendimin nr. 62, datë 10.03.2022, me të cilën është konkluduar se:

“Holta Zaçaj, nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish- Sigurimi i Shtetit; nuk figuron të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

ii. Kontrolli mbi shtetësinë dhe zotësinë për të vepruar.

39. Neni 7/a pika 1 shkronja “a” e ligjit nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi shtetësinë shqiptare dhe zotësinë e plotë për të vepruar. Kandidatja Holta Zaçaj, me atësi Vladimir, amësi Adriana, lindur më datë 12.01.1976, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me nr. ID H65112129V, sipas përgjigjes së kthyer nga Zyra e Gjendjes Civile me nr.prot.1654/1, datë 25.02.2022, rezulton me shtetësi shqiptare. Përgjatë procedurës së verifikimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që këtij kandidati t'i jetë hequr apo t'i jetë kufizuar zotësia për të vepruar.

iii. Kontrolli mbi arsimin e kandidatit

40. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : *GJYKATA ELARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri*
Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

kandidati të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ka kryer studimet në vitet 1994 – 1998 dhe është diplomuar në vitin 1998 si “Juriste”, në Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

iv. Kontrolli për ushtrim funksione politike

41. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 2, datë 23.02.2022, ka miratuar ndryshimet në vendimin nr. 4 datë 11.03.2019, “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke bërë pjesë të tij “*Formularin e vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*”, i cili u botua në fletoren zyrtare nr. 33, datë 01.03.2022. Këto ndryshime u kushtëzuan nga fakti se në praktikën e KED-së në vitet të mëparshme, partitë politike, nuk dërgonin informacionin e nevojshëm, duke ndikuar dhe vështirësuar marrjen e informacionit lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin e kandidatëve në ndonjë pozicion drejtues në parti politike.
42. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, më datë 02.03.2022, ka njoftuar me email kandidaten Holta Zaçaj që të paraqesë këtë formular të plotësuar, jo më vonë se 3 ditë nga marrja e këtij njoftimi. Kandidatja Holta Zaçaj, më datë 07.03.2022, ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, duke deklaruar se nuk ka pasur ndonjë pozicion drejtues në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit.
43. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi më datën 30.03.2022 i është drejtuar, më kërkesë për informacion, partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në lidhje me këtë kërkesë, pjesa më e madhe e partive politike nuk kanë kthyer ende përgjigje. Partitë politike që kanë kthyer përgjigje, konkretisht, *Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Evropiane, Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Aleanca Kombëtare*, kanë informuar për mos ekzistencën e të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Holta Zaçaj.

v. Kontrolli mbi përvojën profesionale të kandidatit në punë.

44. Në pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet se, *kandidati duhet të ketë përvojën e punës prej të paktën prej 15 vjet në detyrën e gjyqtarit, prokurorit, avokatit, profesorit ose lektorit të së drejtës, nëpunësit të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

tjera të së drejtës, si dhe të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

45. Lidhur me këtë kusht, nga dokumentet (shkresa e vërtetime) të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës që janë të administruara në dosjen e kandidimit, përfshirë dhe jetëshkrimin e deklaruar prej saj, rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ka ushtruar veprimtarinë profesionale si më poshtë vijon:
- a) Avokate, për periudhën Janar 2020 e në vijim, pranë Zyrës së Avokatisë “Zaçaj Laë PC. Anëtare e Komitetit për Shërbimet e Mbrojtësit Publik – Divizioni për fëmijët dhe familjen në shtetin e Massachusetts, SHBA.
 - b) Avokate, për periudhën Maj 2019 – Janar 2020, pranë Ligris and Associates PC, SHBA.
 - c) Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Ligjore, për periudhën Maj 2013 – Tetor 2018, pranë Alpha Bank Albania SHA. Përgjegjësitë e kryera: konsulente ligjore pranë Bordit të Drejtorëve, mbrojtja e interesave të Bankës (avokat i bankës), përgjegjëse për hartimin e të gjitha kontratave të bankës.
 - ç) Avokat/Partner, për periudhën Korrik 2008 – Prill 2013 dhe Janar 2019 e në vazhdim, pranë “Delegibus Consulting”, firmë ligjore.
 - d) Pedagoge e jashtme/specialiste, Viti akademik 2009-2013, pranë Shkollës së Magjistraturës.
 - dh) Trajnues, Viti akademik 2010-2011, pranë Shkollës së Magjistraturës.
 - e) Trajnues, Viti akademik 2009-2010, pranë Shkollës së Magjistraturës.
 - ë) Trajnues, Viti akademik 2008-2009, pranë Shkollës së Magjistraturës
 - f) Pedagoge me kohë të pjesshme¹, Viti akademik 2013-2014, pranë Universitetit Luarasi.
 - g) Pedagoge e jashtme², Viti akademik 2009-2010, pranë Universitetit Europian të Tiranës.
 - gj) Avokate/Drejtores ekzekutive, Gusht 2002 – Maj 2007, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI).
 - h) Bashkëdrejtore, 1999-2002, pranë Qendrës Paqe nëpërmjet Drejtësisë (Kandidatja referon se subjekti është mbyllur, nuk është më aktiv).
46. Gjithashtu, referuar këtij dokumentacioni dhe jetëshkrimit të dorëzuar prej saj, kandidatja Holta Zaçaj rezulton se ka qenë autore/bashkëautore/kontribues dhe kërkuese shkencore në një sërë publikimesh profesionale dhe kërkimesh shkencore, si dhe është vlerësuar me çmime të ndryshme.
47. Për këtë kandidatë, Këshilli Emërimeve në Drejtësi ka kërkuar informacion pranë institucioneve publike dhe subjekte private, në të cilat ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit. Konkretisht:
- Me shkresën nr. 414 prot., datë 01.04.2022, i është kërkuar informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë e cila, me shkresën nr. 192 prot., datë 8.4.2022, ka informuar se, *Zonja Holta Zaçaj është avokate dhe mban licencën e avokatisë me nr. 2461. Ka ushtruar profesionin e avokatit prej vitit*

¹ Me kohë të pjesshme rezulton në shkresën e këtij universiteti, të paraqitur në KED nga vetë kandidatja.

² E jashtme, rezulton në shkresën e këtij universiteti, të paraqitur në KED nga vetë kandidatja.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

2005 e në vazhdim. Zonja Zaçaj nuk ka detyrime financiare ndaj subjektit tonë dhe ndaj saj nuk janë marrë masa disiplinore;

- Me shkresën nr. 415 prot., datë 01.04.2022, i është kërkuar informacion Bankës Alpha Albania SHA e cila, me shkresën nr. 15653 prot., datë 05.4.2022, ka informuar se, *periudha e punësimit në Alpha Bank është 8.4.2013 – 31.10.2018 pozicioni i punës ka qenë Drejtore pranë Departamentit të Shërbimeve Ligjore. Znj. Holta Zaçaj nuk ka qenë asnjëherë subjekt i masave disiplinore. Vlerësimi profesional për Znj. Holta Zaçaj për vitet e punësimit pranë Alpha Bank Albania SHA, ka qenë maksimal;*
- Me shkresën nr. 419 prot., datë 07.04.2022, i është kërkuar informacion Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) e cila, me shkresë të datës 22.4.2022, ka informuar se, *punësimi i Znj. Zaçaj pranë QSHPLI ka qenë Drejtore Ekzekutive nga data 7 prill 2004 deri në 16 Prill 2007, gjatë kësaj periudhe, duke filluar nga data 16.7.2005 Znj. Zaçaj ka punuar edhe si avokate pranë QSHPLI. Zonja Zaçaj përgjatë periudhës kohore viti 2013 e në vazhdim ka vazhduar të angazhohet pranë QSHPLI si avokate për dhënien e ndihmës falas për grupet vulnerabile që Qendra ka asistuar. Znj. Zaçaj nuk ka marrë masa disiplinore;*
- Me shkresën nr. 420 prot., datë 11.04.2022, i është kërkuar informacion De Legibus Consulting SHPK e cila, me shkresë të datës 20.4.2022, ka informuar se, *punësimi i Znj. Zaçaj pranë shoqërisë De Legibus Consulting SHPK ka qenë me kohë të plotë nga periudha Korrik 2008 deri në Mars 2013. Përgjatë kësaj periudhe janë derdhur rregullisht kontributet. Pozicioni i ushtruar ka qenë Avokate dhe Juriste e shoqërisë De Legibus Consulting SHPK. Zonja Zaçaj ka vazhduar të mbetet si avokate e asociuar pranë firmës ligjore De Legibus Consulting SHPK gjatë periudhës Mars 2013 e në vazhdim. Ajo punon si avokate me honorare apo kontrata të veçanta shërbimi, duke derdhur pranë zyrës kontribute sipas rastit. Znj. Zaçaj nuk ka marrë masa disiplinore.*
- Me shkresat nr. 426 prot., datë 22.4.2022 dhe 455 prot., datë 23.5.2022, i është kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Tatimore (DRT) Tiranë e cila, me shkresën nr. 8460/1, datë 30.5.2022, për Holta Vladimir Zaçaj me nr. personal H65112129V, ka informuar se:
 1. Për periudhën e punësimit 1.12.2011-9.3.2013 në subjektin De Legibus Consulting me NIPT K81924011V, rezulton e deklaruar me funksion/profesion “Jurist”.
 2. Për periudhën e punësimit 8.4.2013-31.10.2018 në subjektin Banka Alpha Albania me NIPT J72311006R, rezulton e deklaruar me funksion/profesion “Drejtore Shërbimesh financiare”.
 3. Për periudhën e punësimit 10.12.2013-1.11.2014 në subjektin Universiteti Luarasi me NIPT K31526058G, rezulton e deklaruar me funksion/profesion “Pedagog universiteti”. Në sistemin tatimor, mbarten të dhëna në lidhje me listëpagesat dhe formularët e ndryshimit të punonjësve të subjekteve, duke filluar nga periudha tatimore Dhjetor 2011 e në vijim. Për sa më lart, çdo informacion me datë më të hershme nuk administrohet nga administrata tatimore.”.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

III. Njoftimet dhe paraqitja e relacionit për Mbledhjen e KED

48. Sa më sipër, në datën 08.07.2022 është përgatitur ky relacion që përshkruan procedurën e zhvilluar, që shoqërohet edhe nga projekt-akti për përfundimin e procedurës së kandidimit të kandidatës Holta Zaçaj për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 21.02.2019, datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe rishpallur në datë 15.11.2021. Këto akte i paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje mbledhjes së KED-së.
49. Gjithashtu, pas komunikimit me kryetarin e KED-së dhe caktimit të mbledhjes, kandidatës Holta Zaçaj i njoftohet në rrugë elektronike koha e zhvillimit të mbledhjes, duke i dërguar edhe kopje e këtij relacioni. Njoftimi i saj kryhet në zbatim të pikës 34 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, duke administruar një kopje të njoftimit në dosjen e kandidatit.
50. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materialet të çështjes, i dërgohen edhe Avokatit të Popullit. Kopje e këtij njoftimi administrohet gjithashtu në dosjen e kandidatit.
51. Koha e zhvillimit të mbledhjes, rendi i ditës dhe relacioni i përgatitur për kandidaten Holta Zaçaj i njoftohen edhe subjekteve, të cilët sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e KED-së. Edhe kopjet e këtyre njoftimeve administrohen në dosjen e kandidatit.
52. Gjithashtu, dita dhe ora e zhvillimit të mbledhjes së KED-së, si dhe rendi i ditës publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.
53. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të çështjes nga anëtarë relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e tjerë të KED, kjo e fundit dëgjoji mendimin e Avokatit të Popullit, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatës Holta Zaçaj.
54. Në thelb, Avokati i Popullit shprehu qëndrimin se veprimet verifikuese ishin të plota, se vetë Avokati i Popullit ishte njoftuar rregullisht për aktet e mbledhura dhe se nuk ka vërejtje për procedurën e ndjekur.

IV. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

55. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidatës Holta Zaçaj për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 21.02.2019, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe rishpallur në datë 15.11.2021.

56. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteria të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”.

57. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

58. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr. 851/5 prot., datë 27.04.2022, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, aktin e kontrollit të plotë nr. prot. 676/23, datë 27.04.2022, në përfundim të së cilës ka konstatuar se, për kandidaten Holta Zaçaj.

59. Në përfundim të analizës së hollësishtme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruar nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarinë e pasurisë dhe interesave private të kandidates Holta Zaçaj, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.

b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.

c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- c) Nuk ka kryer deklarim të rremë.
- d) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

60. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshilli i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklaratimet e bëra nga kandidatja Holta Zaçaj pranë ILDKPKI me Deklaratën e e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.
61. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatës Holta Zaçaj.
62. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Holta Zaçaj ka “kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235, të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidatë nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.
63. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidatja Holta Zaçaj ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015. “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.
64. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 217/1 prot., datë 23.02.2022, ka bërë me dije Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, se: “Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të bashkëpunimit mes institucioneve, për sa i përket verifikimit të figurës dhe integritetit të kandidatit, në referim nenit 228 dhe nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka vijuar duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion të plotë prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, sipas objektit të veprimtarisë së tyre, lidhur me çështjet penale/ procedimet penale të rregjistruara ndaj secilit kandidat të përcjellë. Ky informacion do t’ju vihet në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për të kryer verifikimin e plotë e të thelluar të kandidatëve për gjyqtar të në Gjykatën Kushtetuese, jemi në pritje të kërkesës suaj:
 - për emrat e kandidatëve për të cilët nevojitet verifikim i plotë i thelluar i të dhënave, së bashku me
 - dokumentet që përmbajnë indicie, të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht dhe ato të deklaruara ndryshe në formular, që rezultojnë nga verifikimi paraprak i kryer prej jush, në zbatim të Kreut III dhe të Kreut IV, pika 1,2,3 të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.”.
65. Prokuroria e Përgjithshme, në vijim, me shkresën nr. 217/3 prot., datë 04.03.2022, ka kthyer përgjigje, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke bërë me dije se “Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Prokuroria e Përgjithshme kryen

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**
 Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formularin e plotësuar nga subjekti i këtij ligji, bazuar në kërkesën e bërë brenda 5 ditëve nga organi kompetente:

- mbi bazën e një kërkesë, ose kryesisht kur disponon të dhëna apo fakte
- kur ka informacion dhe është e nevojshme, që verifikimi të kryhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

....Në kushtet e sipërcituara të ligjit, Prokuroria e Përgjithshme, sikurse ju ka sqaruar dhe me shkresën tonë nr. 217/1, datë 28.02.2022, ju kërkon plotësimin e të metave të kërkesës suaj, brenda 15 ditëve nga marrja e kësaj kërkesë, për të mos u bërë pengesë për kryerjen e procesit të verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe të ligjit nr. 115/2016.

....Gjithashtu ju bëjmë me dije se nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të krijuar për këtë qëllim në Prokurorinë e Përgjithshme, rezulton që:

- Për Holta Vladimir Zaçaj, kandidate për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 15.11.2021, nuk është kryer ndonjë proces verifikimi në zbatim të ligjit nr. 138/2015..”.

66. Në lidhje me këtë kandidat, në përgjigje të kërkesës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dërguar me shkresën nr.prot. 47 datë 15.02.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr.prot. 1654/1 të datës 25.02.2022, ka informuar se: “Me lidhjen e martesës më datë 22.5.1996, shtetasja në fjalë ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, duke e ndryshuar këtë përbërës nga “Zaçaj”, në “Kotherja”. Me zgjidhjen e martesës më datë 25.7.2009, shtetasja në fjalë ka marrë mbiemrin “Zaçaj”.
67. Ndërsa, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr.prot. 1804/1 të datës 21.02.2022, të dërguar në përgjigje të kërkesës nr.prot.48 me datë 15.02.2022 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ka informuar se kjo kandidate: “Rezulton e padënuar nga gjykata penale shqiptare”;
68. Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. 646/2 prot., datë 30.03.2022, të dërguar në përgjigje të kërkesës nr. 310 prot., datë 17.03.2022 së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ka trasmetuar përgjigjen e Zyrës së Protokoll-Arkivës, e cila informon se:

Për shtetasen Holta Vladimir Zaçaj, nga verifikimi i kryera nuk ka të dhëna për dënime penale të formës së prerë ose jo përfundimtare të dhëna nga autoritete të huaja, masa sigurimi të caktuara nga autoritete gjyqësore të huaja, urdhër kërkimi ndërkombëtar të lëshuar nga autoritete ligjzbatuese të huaja, procedime penale të regjistruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me identitetet të ndryshme, nga ato që kanë momentalisht, nuk mund të japim informacion, pasi nuk është në kompetencën tonë.

69. Prokuroria e Përgjithshme, në vijim, bashkëlidhur shkresës me nr. 217/42 prot., datë 08.04.2022, ka dërguar shkresën nr. 3109/1 prot., datë 16.03.2022 e marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cila ka informuar se:

Ndaj shtetasen Holta Vladimir Zaçaj, e datëlindjes 12.1.1976, është regjistruar kallëzimi penal nr. 4207, viti 2015, për të cilin është marrë vendim mosfillimi të procedimit penal më datë 15.5.2015, si dhe procedimi penal nr. 7616, viti 2019, për

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili është dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim më datë 14.5.2019.

70. Lidhur sa më sipër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. prot. 458, datë 23.05.2022, ka kërkuar informacion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila, me shkresën nr. 1394 prot., datë 07.06.2022, ka informuar se: *"Pas verifikimeve të bëra në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Penale të Gjykatës për periudhën 2015 – 2022, lidhur me shtetasen Holta Vladimir Zaçaj, nuk rezulton të ketë pasur ankim për vendimin e mosfillimit të procedimit penal me nr. 4207, të vitit 2015. Në lidhje me procedimin penal nr. 7616, të vitit 2019, bashkëlidhur ju dërgojmë vendimin nr. 2756 akti, datë 25.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."*

Me vendimin nr. 2756 akti, datë 25.6.2019, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *"Pushimin e procedimit penal nr. 7616 regjistruar pranë prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 1.10.2018, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal."* Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar më datë 31.7.2019.

71. Në lidhje me këtë kandidatë, gjithashtu Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. prot. 456, datë 23.05.2022, ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) e cila, me shkresën nr. prot. 4423/1, datë 27.05.2022, ka informuar se: *" Pas verifikimit në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nuk rezulton që në emër të Holta Vladimir Zaçaj e datëlindjes 12.01.1976, me nr. personal H65112129V, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal"*.

72. Sa më sipër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke mos evidentuar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara në nenin 2 të ligjit nr. 138/2015 *"Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*, vjen në përfundimin se, bazuar në 3 të po këtij ligji dhe në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Holta Zaçaj nuk gjendet në kushtet e ndalimit për të kandiduar.

73. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidatja Holta Zaçaj ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit *"Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta"* parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

74. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, pas kontrollit të ushtruar, me shkresën nr. 321/3 prot., datë 11.03.2022, ka përcjellë, në Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, vendimin nr. 62, datë 10.03.2022, me të cilën është konkluduar se:

"Holta Zaçaj, nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish- Sigurimi i Shtetit; nuk figuron të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektrike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. i ndryshuar.

75. Nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se kandidatja Holta Zaçaj, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidatë nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.
76. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidatja Holta Zaçaj *“ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”*. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
77. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me me shkresën nr. 820 prot., datë 16.03.2022, për këtë kandidatë ka informuar se: *“Në përfundim të procedurave të verifikimit, nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e Znj. Holta Vladimir Zaçaj, në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.”*.
78. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka dërguar përgjigje, me shkresën nr. shkresën nr. 300/1 prot., datë 22.02.2022, ka informuar se, kandidatja Holta Zaçaj: *Nuk figuron të jetë e evidentuar për veprimtari kriminale dhe as lidhje të personave me precedent kriminal.*
79. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Holta Zaçaj nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.
80. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidatja Holta Zaçaj në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant. shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*
Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidati ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të saj.

81. Në pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet që kandidati të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ka kryer studimet në vitët 1994 – 1998 dhe është diplomuar në vitin 1998 si “Juriste”, në Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidatja Holta Zaçaj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.
82. Në pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*. Sipas shkresës nr. 192 prot., datë 8.4.2022, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ushtron veprimtari profesionale si Avokate, nga viti 2005 e në vazhdim.

82.1 Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ka ushtruar veprimtaritë profesionale të mëposhtme:

- a) Avokate, për periudhën Janar 2020 e në vijim, pranë Zyrës së Avokatisë “Zaçaj Laë PC. Anëtare e Komitetit për Shërbimet e Mbrojtësit Publik – Divizioni për fëmijët dhe familjen në shtetin e Massachusetts, SHBA.
- b) Avokate, për periudhën Maj 2019 – Janar 2020, pranë Ligris and Associates PC, SHBA.
- c) Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Ligjore, për periudhën Prill 2013 – Tetor 2018, pranë Alpha Bank Albania SHA. Përgjegjësitë e kryera: konsulente ligjore pranë Bordit të Drejtorëve, mbrojtja e interesave të Bankës (avokat i bankës), përgjegjës për hartimin e të gjitha kontratave të bankës.
- ç) Avokat/Partner, për periudhën Korrik 2008 deri në Mars 2013, si dhe avokate me honorare gjatë periudhës Mars 2013 e në vazhdim, pranë “De Legibus Consulting”, firmë ligjore.
- d) Pedagoge e jashtme/specialiste, Viti akademik 2009-2013, pranë Shkollës së Magjistraturës.
- dh) Trajnues, Viti akademik 2010-2011, pranë Shkollës së Magjistraturës.
- e) Trajnues, Viti akademik 2009-2010, pranë Shkollës së Magjistraturës.
- ë) Trajnues, Viti akademik 2008-2009, pranë Shkollës së Magjistraturës
- f) Pedagoge me kohë të pjesshme, Viti akademik 2013-2014, pranë Universitetit Luarasi.
- g) Pedagoge e jashtme, Viti akademik 2009-2010, pranë Universitetit European të Tiranës.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- gj) Avokate/Drejtores ekzekutive, Prill 2004 – Prill 2007, si dhe avokate nga viti 2013 e në vazhdim, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI).
- h) Bashkëdrejtores, 1999-2002, pranë Qendrës Paqe nëpërmjet Drejtësisë (Kandidatja referon se subjekti është mbyllur, nuk është më aktiv).
83. Gjithashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., kandidatja Holta Zaçaj ka deklaruar se ka qenë autore/bashkëautore/kontribues dhe kërkuese shkencore në një sërë publikimesh profesionale dhe kërkimesh shkencore, ka disa kualifikime pasuniversitare, ka marrë pjesë në trajnime, si dhe është vlerësuar me çmime të ndryshme.
84. Bazuar në gjetjet e cituara në pikën 81-83 më sipër, Këshilli konstaton se kandidatja Holta Zaçaj ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.
85. Në pikën 5 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit. Sikurse parashtrohet në pikën 82-84 më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se: *kandidatja Holta Zaçaj nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike, gjatë periudhës së përcaktuar nga ligji. Për rrjedhojë kandidatja Holta Zaçaj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.*
86. Në pikën 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjën “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike dhe nga formulari i vetëdeklarimit të paraqitur nga kandidatja Holta Zaçaj, Këshilli konstaton se: *kandidatja nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë periudhës së përcaktuar nga ligji. Për rrjedhojë, kandidatja Holta Zaçaj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.*
87. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidatja Holta Zaçaj nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidatja të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë kandidatja Holta Zaçaj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

87. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatës Holta Zaçaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 21.02.2019, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe rishpallur në datë 15.11.2021.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/ç të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe pikave 8, 28, 31, 78 të vendimit të KED-së nr. 4, datë 11.03.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit Holta Zaçaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 21.02.2019, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe rishpallur në datë 15.11.2021.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Holta Zaçaj.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETAR

Sokol BINAJ

